

### Prezantohet Strategjia “Për zhvillimin e AMF-së dhe tregjeve në mbikëqyrje 2018-2022”

#### Vështrim mbi tregjet

- Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për janar-prill 2018

#### Zhvillime të tjera

- AMF zhvillon konferencën kombëtare për edukimin financiar
- AMF publikon projektligjin e ri "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit"
- Fondi Monetar Ndërkombëtar vlerëson progresin e bërë nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

#### Edukimi i Konsumatorit

- Kriptomonedhat – “E mira, e keqja dhe e shëmtuara” (pjesa e parë)

#### Publikime

- OECD publikon “Zhvillimet Ekonomike, 2018, nr. 1”
- OECD publikon “Produktiviteti dhe vendet e punës në një botë të globalizuar: (Si) A mund të përfitojnë të gjitha rajonet?”
- OECD publikon “Treguesit Ekonomikë, 2018, nr. 6”

#### Lajme Ndërkombëtare

- Kosovë
- Kroaci
- Mali i Zi
- Slloveni
- Vendet e Evropës Qendrore e Lindore

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

## Prezantohet Strategjia “Për zhvillimin e AMF-së dhe tregjeve nën mbikëqyrje 2018-2022”



*Konferenca për prezantimin e Strategjisë së AMF*

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare prezantoi më 14 maj 2018 Strategjinë 5-vjeçare të zhvillimit të AMF-së dhe tregjeve nën mbikëqyrje për periudhën 2018-2022.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare prezantoi më 14 maj 2018 Strategjinë 5-vjeçare të zhvillimit të AMF-së dhe tregjeve nën mbikëqyrje për periudhën 2018-2022. Ai është një dokument i rëndësishëm që harmonizon së bashku axhendën e integritit në Bashkimin Evropian, me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik e shoqëror të vendit dhe objektivat financiarë të rritjes së Autoritetit.

Në prezantimin e strategjisë merrnin pjesë drejtues të lartë të AMF-së, Zv/Guvernatorja e Bankës së Shqipërisë, Znj. Natasha Ahmetaj, përfaqësues të shoqatave dhe drejtuesit ekzekutivë të kompanive të tregjeve nën mbikëqyrjen e AMF-së.

Duke prezantuar Strategjinë, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, Z. Ervin Koçi theksoi se “AMF synon që implementimi i kësaj strategjie të nxisë zhvillimin e një tregu konkurrent dhe eficient, duke krijuar njëkohësisht stabilitet afatgjatë si dhe duke i dhënë mundësi krijimit dhe zhvillimit të produkteve inovative. Autoriteti është i bindur se zbatimi i kësaj strategjie, e shoqëruar çdo vit me prioritete të qarta e me një plan konkret veprimi, do të transformojë tregjet financiare që ne mbikëqyrim duke i kthyer në promotor të zhvillimit ekonomik të vendit si dhe autoritetin në një model pozitiv të funksionimit të një mbikëqyrje efektive.”

Ndërsa Kryetari i Bordit të AMF-së, Z. Pajtim Melani duke vlerësuar me shifra arritjet e deritanishme, theksoi hapjen e të parës Bursë me kapital privat si një ndër arritjet më të spikatura të vitit të kaluar. Ai deklaroi se AMF do ta shoqërojë hartimin e kësaj strategjie me një plan konkret veprimi për të arritur objektivat e vendosura.

Strategjia ka tre pjesë përbërëse që janë: (i) identiteti i AMF-së, (ii) boshtet e zhvillimeve strategjike sipas tregjeve; dhe (iii) infrastruktura ligjore.

Për secilën nga këto pjesë përbërëse, Strategjia analizon situatën aktuale dhe vendos objektiva për t'u realizuar për të ardhmen. AMF synon t'i arrijë objektivat kryesore të zhvillimit duke vendosur gjithë potencialin e saj mbikëqyrës e rregullator drejt punës për krijimin dhe forcimin e tregjeve financiare jobankare që ato:

- Të shkojnë drejt niveleve evropiane, si tregje financiare të sigurta dhe transparente;
- Të rrisin besimin e konsumatorit;
- Të rrisin rolin si financues të ekonomisë kombëtare.

Strategjia e detajuar është shumë më voluminoze dhe përmban 72 rekomandime që janë kthyer në 72 prioritete, objekt i punës së përbashkët në 5 vitet e ardhshme. Për disa specifikime më shumë për tregjet dhe strategjinë, në aktivitet bënë prezantimet e tyre edhe drejtuesit e departamenteve të mbikëqyrjes së tregut të sigurimeve dhe tregut të kapitaleve dhe fondeve.

---

Strategjia e detajuar është shumë më voluminoze dhe përmban 72 rekomandime që janë kthyer në 72 prioritete, objekt i punës së përbashkët në 5 vitet e ardhshme.

---

# VËSHTRIM MBI TREGJET

## Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-prill 2018

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit gjatë periudhës janar-prill 2018 kapën vlerën mbi 4.89 miliardë lekë, ose 3.34% më shumë se gjatë periudhës janar-prill 2017. Gjatë periudhës janar-prill 2018, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 356,630 me një rritje prej 6.07% krahasuar me periudhën janar-prill 2017.

Një tjetër tregues i ecurisë së tregut, dëmet e paguara bruto, në total, regjistruan një ulje me 17.60% në krahasim me periudhën janar-prill 2017. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto i përket sigurimit motorik me rreth 1,106 milionë lekë, apo 70.44 % të totalit të dëmeve të paguara bruto.

### Sigurimi i Jo-Jetës

Sigurimi i Jo-Jetës u rrit me 4.00% gjatë periudhës janar-prill 2018, krahasuar kjo me periudhën janar-prill 2017.

### Sigurimi i detyrueshëm motorik

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohet të kenë arritur vlerën rreth 2.98 miliardë lekë gjatë periudhës janar-prill 2018, duke shënuar një rritje prej 7.77% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Sigurimi i detyrueshëm motorik gjatë periudhës raportuese përbën 60.80% të tregut të sigurimeve.

### Klasa të tjera në sigurimet e Jo-Jetës

Ndër klasat e tjera kryesore të sigurimit të Jo-Jetës veçohen:

- Sigurimi i aksidenteve, sigurimi i shëndetit dhe sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme, të cilat së bashku zunë 13.24% të tregut të Jo-Jetës;
- Zjarri, forcat e natyrës dhe dëmtime të tjera në pronë të cilat zunë 14.92 % të tregut të Jo-Jetës.


Gjatë periudhës janar-prill 2018, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 356,630 me një rritje prej 6.07% krahasuar me periudhën janar-prill 2017.

## Sigurimi i Jetës

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u ulën me 6.24% krahasuar me periudhën janar-prill 2017. Pjesa më e madhe e primeve të shkruara bruto i përket sigurimit “Jetë debitori” e cila përbën 66.40% të sigurimit të Jetës.

## Ndarja e tregut të sigurimeve, janar–prill 2018

Grafiku më poshtë paraqet ndarjen e volumit total të primeve të shkruara bruto sipas grupeve kryesore:



## ZHVILLIME TË TJERA

### AMF zhvillon konferencën kombëtare për edukimin financiar

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, Z. Ervin Koçi, u ndal te rëndësia e edukimit financiar në funksion të mbrojtjes së konsumatorëve dhe investitorëve, në funksion të zhvillimit të mëtejshëm të tregjeve financiare jobankare.



*Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, Z. Ervin Koçi, në konferencën kombëtare për edukimin financiar*

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare zhvilloi më datë 24 maj 2018, Konferencën Kombëtare “Edukimi Financiar” me fokus kryesor studentët, të cilët shpalosën punime të ndryshme në lidhje me tregjet nën mbikëqyrje dhe rëndësinë e edukimit financiar për zhvillimin e tyre.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, Z. Ervin Koçi, u ndal te rëndësia e edukimit financiar në funksion të mbrojtjes së konsumatorëve dhe investitorëve, në funksion të zhvillimit të mëtejshëm të tregjeve financiare jobankare.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së u shpreh se “Konferenca që ne po zhvillojmë sot, është fillimi i një dialogu të përbashkët me stafet akademike, ekspertë të tregjeve financiare jobankare dhe organizma që veprojnë në treg për të përcjellë ide të reja në përballimin e sfidave me të cilat ndeshen tregjet nën mbikëqyrjen e AMF-së. Ky dialog i hapur sot do të na ndihmojë të kemi një pasqyrë më të saktë të tendencave dhe përvojave më të mira në zhvillimin e tregjeve financiare jobankare. Dua të theksoj këtu se në bashkëpunim me ekspertë e specialistë të fushave, AMF hartoi një Strategji 5-vjeçare zhvillimi, me synimin për t’i kthyer tregjet tona të brishta, në tregjet me ecurinë më pozitive dhe si tregu financiar jobankar më i konsoliduar në Ballkanin Perëndimor”.

Kryetari i Bordit të AMF-së, Z. Pajtim Melani tha se edukimi financiar është investimi më i sigurtë për një rritje ekonomike afatgjatë. Ai ftoi kompanitë financiare të investojnë më shumë në promovimin e edukimit financiar.

Në përfundim të konferencës, Autoriteti dhe shoqatat e tregjeve nën mbikëqyrje, Shoqata e Siguruesve të Shqipërisë, Shoqata e Siguruesve të Jetës, Pensioneve Private dhe Fondeve të Investimit, si dhe Shoqata e Tregimit të Titujve në Shqipëri shpërndanë çmime të ndryshme për punimet më të mira.

Konferenca u përshëndet edhe nga Drejtoresha e Arsimit Parauniversitar, Znj. Zamira Gjini, e cila theksoi se për Ministrinë e Arsimit edukimi për sipërmarrjen është ndër drejtimet e rëndësishme të punës së tyre. Ajo theksoi se në bashkëpunim me AMF-në “ne sot po vendosim disa prioritete të reja për të lidhur edukimin e sipërmarrjes dhe zhvillimin e karrierës për studentët me tregun e punës”.

Temat kryesore të trajtuara përgjatë konferencës ishin:

- Sfidat për edukim financiar cilësor në arsimin parauniversitar;
- Dixhitalizimi në tregun e sigurimeve;
- Fondet e investimit në Shqipëri dhe krahasimi me fondet e investimit në botë;
- Bursa dhe faktorët që ndikojnë në funksion të saj;
- Arbitri mbi mosmarrëveshjet financiare: një model i ri për mbrojtjen e investitorëve;
- Vlerësimi i edukimit dhe sjelljes financiare në vendimmarrjen financiare;
- Zhvillimi i fondeve të pensioneve private vullnetare, etj.

Në përfundim të konferencës, Autoriteti dhe shoqatat e tregjeve nën mbikëqyrje, Shoqata e Siguruesve të Shqipërisë, Shoqata e Siguruesve të Jetës, Pensioneve Private dhe Fondeve të Investimit, si dhe Shoqata e Tregimit të Titujve në Shqipëri shpërndanë çmime të ndryshme për punimet më të mira.

Çmimet lidheshin me kontrata punësimi në shoqëritë që veprojnë në tregjet nën mbikëqyrje, mundësinë e intershipeve apo dhurimin e pajisjeve dixhitale për studentët. AMF synon që kjo konferencë me studentët të shndërrohet në një aktivitet të përvitshëm duke i shërbyer edukimit financiar dhe përfshirjes më të madhe të të rinjve në tregjet nën mbikëqyrje.

## AMF publikon projektligjin e ri "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit"

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka depozituar në Ministrinë e Financave projektligjin e ri "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit". Ndryshimet e realizuara në këtë projektligj kanë ardhur si pjesë e një procesi të gjerë konsultues me aktorët e tregut dhe me asistencën e ekspertëve të Bankës Botërore.

Projektligji i referohet praktikave më të mira evropiane dhe ndryshimet janë realizuar duke marrë parasysh edhe përafrimin e legjislacionit me standardet e BE-së. Ndryshimet kanë për synim kryesor zgjidhjen e problematikave të vërejtura në tregun e sigurimeve gjatë viteve të fundit, me qëllim mbrojtjen më të mirë të konsumatorit, krijimin e besimit, si edhe zhvillimin e mëtejshëm të tregut.

## Fondi Monetar Ndërkombëtar vlerëson progresin e bërë nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

Fondi Monetar Ndërkombëtar, në përfundim të Monitorimit të Parë të kryer pas Përfundimit të Programit me Shqipërinë, ka vlerësuar ecurinë e ekonomisë shqiptare. Raporti nënvizon se ekonomia shqiptare ka vazhduar të rritet, duke shënuar një rritje reale të Prodhimit të Brendshëm Bruto prej 3.8% gjatë vitit 2017.

Në analizën e tregjeve financiare jobankare, raporti i Fondit Monetar Ndërkombëtar vlerëson pozitivisht punën e bërë nga AMF dhe thekson se "Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka bërë një progres rrënjësor lidhur me përmirësimin dhe adoptimin e kuadrit të ri rregullativ në lidhje me mbikëqyrjen e tregut të kapitaleve dhe fondeve, duke përmendur hartimin e rregulloreve të reja mbi administrimin e likuiditetit të fondeve të investimeve, transaksionet me palët e lidhura, etj.

Autoriteti është i angazhuar për plotësimin e gjithë rekomandimeve të lëna nga Raporti i Fondit Monetar Ndërkombëtar lidhur me:

- Kuadrin rregullator për menaxhimin e krizave për fondet e investimeve, që aktualisht në bashkëpunim edhe me Ministrinë e Financave dhe Bankën e Shqipërisë është drejt përfundimit;
- Krijimin e kuadrit të nevojshëm ligjor dhe rregullator për instrumentet e reja, për bursën e sapo licencuar, sipas standardeve më të mira ndërkombëtare.

Në analizën e tregjeve financiare jobankare, raporti i Fondit Monetar Ndërkombëtar vlerëson pozitivisht punën e bërë nga AMF.



## **PUBLIKIME**

OECD publikon “Zhvillimet Ekonomike - 2018 nr. 1” (*OECD Economic Outlook Volume 2018 Issue 1 - Preliminary Version*)

Botimi “*OECD Economic Outlook Volume 2018*” trajtohen risitë e zhvillimit ekonomik, politikat dhe sfidat e ndjekura drejt integritit financiar, si edhe perspektiva në dy vitet në vazhdim. Ky botim publikohet dy herë në vit.

Materialin më të plotë e lexoni në linkun më poshtë:

[https://www.oecd-ilibrary.org/economics/oecd-economic-outlook-volume-2018-issue-1\\_eco\\_outlook-v2018-1-en](https://www.oecd-ilibrary.org/economics/oecd-economic-outlook-volume-2018-issue-1_eco_outlook-v2018-1-en)

OECD publikon “Produktiviteti dhe vendet e punës në një botë të globalizuar: (Si) A mund të përfitojnë të gjitha rajonet? (*Productivity and Jobs in a Globalised World: (How) Can All Regions Benefit?*)

Botimi trajton përdorimin e politikave rajonale, të cilat mbështesin rritjen e produktivitetit në vendet e punës. Ky botim shqyrton në detaje mënyrat e nxitjes së produktivitetit në përmirësimin e marrëdhënieve të punësimit.

Materialin më të plotë e lexoni në linkun më poshtë:

[https://www.oecd-ilibrary.org/employment/productivity-and-jobs-in-a-globalised-world\\_9789264293137-en](https://www.oecd-ilibrary.org/employment/productivity-and-jobs-in-a-globalised-world_9789264293137-en)

OECD publikon “Treguesit ekonomikë, 2018, nr.6” (*Main Economic Indicators, Volume 2018 Issue 6*)

Ky është një botim mujor i OECD-së me treguesit kryesorë ekonomikë duke dhënë tregues të krahasur për 35 vende, disa prej tyre anëtare të zonës Euro dhe disa jo. Materialin më të plotë e lexoni në linkun më poshtë:

[https://read.oecd-ilibrary.org/economics/main-economic-indicators/volume-2018/issue-6\\_mei-v2018-6-en#page1](https://read.oecd-ilibrary.org/economics/main-economic-indicators/volume-2018/issue-6_mei-v2018-6-en#page1)

### Kriptomonedhat – “E mira, e keqja dhe e shëmtuara”

*Iniciativa Paraja 20/20 (Money20/20) lindi pasi industria kishte nevojë për një hapësirë ku njerëz të mençur, krijues dhe ambiciozë të lidhen dhe të krijojnë së bashku. Money20/20 është hapësira - ku zhvillohet një radhë takimesh nga teknologji tek paraja tek njerëzit, më pas idetë dhe deri sa idetë bëhen realitet.*

*Money 20/20 është vendi ku ekosistemi i Pagesave, Teknologjisë Financiare (FinTech) dhe Shërbimeve Financiare bashkohen për të eksploruar mënyrat në të cilat konsumatorët dhe bizneset menaxhojnë, shpenzojnë dhe marrin hua parënë. Pjesë e këtij rrjeti janë drejtues të lartë ekzekutivë të kompanive të fuqishme të cilët bashkohen për të drejtuar ndryshimet që do të ndodhin në të ardhmen e parasë.*

*Iniciativa Money 20/20 ka filluar në vitin 2012 dhe ajo është shtrirë edhe në vende të tjera. Money 20/20 në Azi ka nisur në mars 2018.*

*Marrë me shkurtime është fjala e Z. Ravi Menon, Drejtor Administrativ i Autoritetit Monetar të Singaporit - Monetary Authority of Singapore (MAS), në “Money 20/20”, Singapor, 15 mars 2018.*

*(Pjesa e parë)*

Kjo konferencë është emërtuar pas parasë, e cila ka ekzistuar që prej 5000 vitesh. Gjatë 300 viteve të fundit, ne e kemi pranuar se paraja emetohet nga bankat qendrore, të cilat kanë për mision të tyre të mbrojnë vlerën e parasë.

Tashmë po përballemi me një fenomen të ri – kriptomonedhat ose kryptoasete. Gjatë vitit të kaluar janë shënuar rritje thelbësore në tregtimin dhe përdorimin e këtyre kryptoaseteve. Ne kemi parë gjithashtu një rritje drastike të çmimit të tyre.

Bitcoin - më i njohuri nga kriptomonedhat ose kryptoasetet - arriti një nivel të lartë pothuajse 20,000 USD në dhjetor të vitit të kaluar. Më pas, humbi dy të tretat e vlerës së tij në më shumë se një muaj.

Autoriteti Monetar i Singaporit po e studion këtë situatë me shumë kujdes në vazhdimësi për të parë edhe përshtatjen e mundshme rregullatore. Më poshtë do të përdor një term të përgjithshëm kriptomonedha. Kriptomonedhat (*Crypto tokens*) e filluan veprimtarinë e tyre si mjet këmbimi brenda ekosistemit *blockchain*, por këto kriptomonedha (*token*) tashmë kanë filluar të operojnë jashtë sistemit *blockchain*.

#### A janë kriptomonedhat para?

Një rast i zakonshëm i përdorimit të kriptomonedhave është pagesa. Por a bën kjo që ato të mund të quhen para? Nga leksionet tona të hershme të ekonomisë, praja shërben për tri funksione: si një mjet shkëmbimi, si ruajtje e vlerës dhe njësi llogaritëse.

Bitcoin - më i njohuri nga kriptomonedhat ose kryptoasetet - arriti një nivel të lartë pothuajse 20,000 USD në dhjetor të vitit të kaluar. Më pas, humbi dy të tretat e vlerës së tij në më shumë se një muaj.

Aktualisht asnjë kriptomonedhë nuk i plotëson në mënyrë të mjaftueshme këto tre funksione për tu cilësuar si para.

- Duke përjashtuar përdorimin e mundshëm në *web*, kriptomonedhat nuk pranohen gjerësisht si mjet shkëmbimi në çdo treg, dhe aq më pak për llojet e transaksioneve.
- Kriptomonedhat nuk mund të jenë as një mënyrë për të ruajtur vlerat (*store of value*), ndërkohë që çmimet e tyre pësojnë luhatje të madhe. Që nga fillimi i vitit të kaluar, vlera ditore e Bitcoin kundrejt dollarit amerikan ka shënuar një luhatje rreth 20 herë më të madhe se dollari i Singaporit kundrejt dollarit amerikan.
- Kriptomonedhat nuk e realizojnë as funksionin e tyre si njësi llogarie. Sa subjekte njohim, të cilat i mbajnë pasqyrat e tyre financiare në kriptomonedha?

A do të thotë kjo që kursesi kriptomonedhat nuk mund të bëhen kurrë para? Gjithsesi, me zhvillimet teknologjike nuk mund të themi “kurrë” asnjëherë.

- Një gjeneratë e dytë e kriptomonedhave po lind për të trajtuar disa nga sfidat aktuale që lidhen me mbingarkesën e rrjetit, kohën e transaksionit, kostot, rreziqet nga pastrimi i parave dhe më e rëndësishmja stabilitetin e çmimeve.
- Disa nga mendjet më të ndritura në këtë fushë po aplikojnë energjitë e tyre krijuese për t'i kthyer kriptomonedhat në mjete kryesore këmbimi (*mainstream*).
- Jo të gjithë zhvilluesit e programuesit në *web* për kriptomonedhat janë anarkisë dhe duan të prishin ato çfarë aktualisht ekziston. Mjaft prej tyre e njohin vlerën e stabilitetit.

Testi është krijimi i besimit tek publiku dhe se a do të pranohet nga ata. Historia e emetimit të parave në mënyrë private nuk ka qenë një histori frymëzuese. A do të kenë njerëzit besimin në ato para që nuk mbështeten nga një institucion publik i besuar si në rastin e një bankë qendrore, e cila i dedikohet mbrojtjes së vlerës së saj?

### **E mira, e keqja dhe e shëmtuara e kriptomonedhave**

Pavarësisht nëse kriptomonedhat mund të bëhen apo jo para, ato janë të pranishme dhe shfaqin një sërë aspektesh – “të mira, të keqja dhe të shëmtuara”.

Pavarësisht nëse kriptomonedhat mund të bëhen apo jo para, ato janë të pranishme dhe shfaqin një sërë aspektesh – “të mira, të keqja dhe të shëmtuara”.

Blockchain është e përshtatshme për aplikime ku është e rëndësishme të njihet historia e pronësisë, por nuk ka asnjë palë qendrore të besueshme ose mbështetje në një palë qendrore është e paefektshme ose e kushtueshme.

### “E mira”

Siç është vënë re, më e rëndësishme se kriptomonedhat është teknologjia *blockchain* që këto monedha e kanë ndihmuar të fuqizohet. Teknologjia *blockchain* (me blloqet zinxhir) ka dy karakteristika të dallueshme që realizojnë këtë objektiv:

- Së pari, është një regjistër dhe bazë të dhënash publike dhe transparente (*distributed ledger*). Ai ofron të dhëna mbi zotëruesin e një aseti të caktuar, në kohë të caktuar dhe është një regjistër i pandryshueshëm për të gjitha transaksioneve në atë pasuri;
- Së dyti, është një protokoll për vendosjen e besimit midis palëve të ndryshme në një sistem të decentralizuar:
  - Ku secili ka akses në të njëjtën regjistër;
  - Të dhënat janë të siguruara me kriptografi të avancuar;
  - Transaksionet realizohen nga kontrata inteligjente në përputhje me kushte të rëna dakord më parë.

*Blockchain* është e përshtatshme për aplikime ku është e rëndësishme të njihet historia e pronësisë, por nuk ka asnjë palë qendrore të besueshme ose mbështetje në një palë qendrore është e paefektshme ose e kushtueshme.

Le të marrim për shembull pjesën e ofertës - *Blockchain* mund të sigurojë potencialisht mjetet për regjistrimin, certifikimin dhe ndjekjen e lëvizjes së mallrave në zinxhirin e ofertës, me kosto dhe rrezik të ulët. Ose një shembull tjetër në financimin e tregimit, ka tashmë prova të suksesshme nga bankat që tregojnë se si *Blockchain-s* mund ta bëjnë më të sigurt dhe më efikas procesin e financimit të tregimit. Një nga rastet e përdorimit të kriptomonedhave është lehtësimi i pagesave ndërkufitare në valutat tradicionale.

Autoriteti i Singaporit MAS ka filluar një bashkëpunim me Bankën e Kanadasë për të testuar dhe zhvilluar një zgjidhje ndërkufitare duke përdorur kriptomonedhat të emetuara nga dy bankat qendrore.

Njëlloj siç ndodh me kriptomonedhat, ekziston një propagandë e madhe rreth *blockchains*:

- *Blockchain* nuk është një “kurë çudibërëse” për problemet e paefektshmërisë dhe koston me të cilat përballen shumë transaksione dhe procese ekonomike;
- Nuk ka kuptim të përfshihet gjithçka në *blockchain*;
- Jo të gjitha rastet e përdorimit që do të eksperimentohen, do të jenë të suksesshme.

Kriptomonedhat gjithashtu kanë lehtësuar ransomware, (një program kompjuterik viral që kërcënon të bëjë publike detajet e individëve në rast se nuk i paguhet një shumë e caktuar si shpërblim) një nga krimet kibernetike në rritje.

### “E keqja”

Anonimiteti i kriptomonedhave, fatkeqësisht ka lehtësuar dhe i ka bërë ato të përshtatshme për transaksione të paligjshme.

Një pjesë e rëndësishme e transaksioneve Bitcoin në mbarë botën dyshohet të jetë për qëllime të paligjshme. Pyetjet vërtiten rreth mënyrës si aplikohen kontrollet për listimin, sanksionet, listat e zeza, (*Know your customer, KYC*) ose pastrimin e parave në rastin e transaksioneve të kriptomonedhave.

Kriptomonedhat gjithashtu kanë lehtësuar *ransomware*, (një program kompjuterik viral që kërcënon të bëjë publike detajet e individëve në rast se nuk i paguhet një shumë e caktuar si shpërblim) një nga krimet kibernetike në rritje. Kriminelët kibernetikë vendosin një virus (*malware*) në sistemin e kompjuterit dhe në këtë mënyrë të kufizojnë qasjen tek dokumentet, shpesh duke kërcënuar edhe shkatërrimin e përhershëm të të dhënave nëse nuk paguhet një shpërblim, i cili kryhet pothuajse gjithmonë nëpërmjet Bitcoin që të mos lihet gjurmë.

### “E shëmtuara”

Kriptomonedhat janë përhapur si një epidemi spekulative në mbarë botën, nëpërmjet krijimit të një rrethi vicioz të çmimeve stratosferike që tërheqin një numër gjithnjë e më të madh investitorësh, të cilët nxisin në mënyrë eksponenciale rritjen e çmimeve.

Historia ka treguar në mënyrë të përsëritur që filluskat spekulative kanë një fund të hidhur, duke filluar me “Maninë e Tulipanëve Hollandez” (*Dutch Tulip Mania*) e më pas me aksionet e kompanisë “Deti i Jugut” (*South Sea stocks*). Rënia e çmimeve e kohëve të fundit duhet të jetë një shenjë paralajmëruese. Por, nga ana tjetër, fusha e marketingut për kriptomonedhat, për të kapur çmimet aktuale më të ulëta si një mundësi blerëse, shërben për të shpjeguar se sa e paqëndrueshme, e rrezikshme dhe e shëmtuar është bërë kjo lojë.

Investitorët pjesëmarrës në skemat e kriptomonedhave mund të jenë gjithashtu të ekspozuar ndaj një rreziku më të madh mashtrimi. Këto skema shpesh kryhen *online* nga operatorë, autenticiteti dhe besueshmëria e të cilëve është e vështirë për t'u verifikuar.

## Kosovë

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Tregu i sigurimeve në Kosovë arriti një total prej 21.4 milionë euro në fund të marsit 2018, me një rritje prej 10.5%, sipas të dhënave të publikuara nga Banka Qendrore (CBK). Segmenti i Jo-Jetës u rrit me 10.3%, duke sjellë 20.7 milionë euro, nga të cilat 10.6 milionë euro erdhën nga linja e sigurimit MTPL, 1 milion euro nga policat kufitare dhe 9.1 milionë euro nga klasat e tjera të sigurimit vullnetar. Në të njëjtën kohë, primet e sigurimit të Jetës pësuan rënie me 16%, me një total prej 0.7 milion euro. Në bazë të shifrave u raportua gjithashtu një rënie e të ardhurave neto në 0.4 milion euro, nga 0.9 milion euro të ardhura të raportuara në fund të marsit 2017. Në Kosovë operojnë 15 kompani sigurimi, 12 nga të cilat për sigurimin e Jo-Jetës dhe 3 për atë të Jetës.

## Kroaci

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Tregu i sigurimeve në Kroaci i mbylli tre muajt e parë të vitit 2018 me prime të shkruara bruto në vlerën 373.26 milionë euro, me një rritje prej 7.38%. Ndikimi më i madh në këtë rritje erdhi nga linja tradicionale e sigurimit të Jetës dhe nga i sigurimi motorik. Sigurimi i Jetës u rrit me 6.9%. Rritje shënoi edhe sigurimi i Jo-Jetës, në masën 7.6% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Gjithashtu, në tre muajt e parë të këtij viti u rregjistrua një rritje me 13.9% e dëmeve të paguara nga siguruesit në Kroaci.

## Mali i Zi

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Tregu i sigurimeve në Malin e Zi u rrit me 5.1% në tre-mujorin e parë të vitit 2018, duke sjellë 18.4 milionë euro, ndërsa u shënuar gjithashtu një rritje me 16.2% e pagesës së dëmeve, me një vlerë prej 9 milionë euro. Segmenti i Jo-Jetës gjeneroi 15.5 milionë euro nga primet e shkruara bruto, me një rritje prej 6.9%, ndërsa sigurimet e Jetës sollën 2.9 milionë euro, me një rritje prej vetëm 0.9%. Sa i përket pagesës së dëmeve, u shënuar një rritje me 41% në sigurimin e Jetës, me 1.4 milionë euro, ndërkohë që në sigurimet e Jo-Jetës u paguan 7.6 milionë euro dëme, me një rritje prej 12.6%, kryesisht për shkak të sigurimeve motorike.

## Sloveni

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Siguruesit slovenë e mbyllën tre mujorin e parë të vitit 2018 me prime të shkruara bruto me vlerë 643 milionë euro, me një rritje vjetore prej 5.85%. Përsa i përket pagesës së dëmeve u shënuar një rritje me 10.2%, për një total 411.4 milionë euro, kryesisht për shkak të rritjes së pagesave të dëmeve në sigurimin motorik dhe atë të pronës. Tregu ka shënuar një rritje të ekuilibruar në pjesën më të madhe të kategorive të sigurimit. Në terma absolutë, kontributin kryesor e kanë dhënë sigurimet e Jetës, ndërsa përsa i përket sigurimeve të Jo-Jetës rritjen më të madhe e kanë patur sigurimet e shëndetit.

## Vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Tregu i sigurimeve në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore e mbylli vitin 2017 me një rritje mesatare të primeve të shkruara bruto prej 11.5%, për 36.2 miliardë euro. Segmenti i sigurimeve të Jo-Jetës kontribuoi me 76% të rritjes, thuhet gjysma në linjën e sigurimeve MTPL. Viti 2017 ishte më i miri për ekonominë e vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore (CEE), sipas analistëve. Edhe biznesi i sigurimeve në këtë rajon ka përfituar nga momenti i mirë ekonomik, duke e mbyllur vitin me shifra shumë pozitive. Polonia mbetet vendi lider për rajonin, me 41.4% të totalit të primeve të shkruara bruto. Vlen të përmendet se rritje me 11.5% u shënuar edhe sa i përket dëmeve të paguara. Në terma absolutë, si segmenti i Jetës, ashtu edhe ai i Jo-Jetës patën ndikim thuhet të njëjtë në rritjen e pagesës së dëmeve. Në gjithë rajonin, rritjen më të madhe për vitin 2017 e kanë shënuar Polonia dhe tre shtetet ballklike (Estonia, Lituania dhe Letonia).



---

---

## AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Për informacion të mëtejshëm  
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë  
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686  
[amf@amf.gov.al](mailto:amf@amf.gov.al) | [www.amf.gov.al](http://www.amf.gov.al)